



Më  
Dana

29 - 05 - 2018

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:019726  
Datë: 29.05.2018  
Numri i dokumentit: 00047112

1

P.nr.2876/2017

NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues, Elmaz Zenuni, me Zyrtarin ligjore Gazmend Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna e Kaçanikut, për shkak të vepres penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH-së në Ferizaj PP/II nr.2170-2/2016 të dt.13.11.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 29.05.2018, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit, Valdet Avdiu, të pandehurit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari, [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna e Kaçanikut, i lindur me [REDACTED] në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED], e vajzërisë [REDACTED], punëtor privat i ujësjellësit, i pa martuar, ka të kryer shkollen e mesme, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri,-

## ËSHTË FAJTOR

Sepse me datën 10.09.2016, rreth orës 03:30, në Rrugën "Dëshmorët e Kombit" në afërsi të Spitalit Rajonal në Ferizaj, me rastin e ndaljes dhe kontrollit nga ana e zyrtarëve policor është konstatuar se i njejt pa autorizim posedonte një qese substancë narkotike të llojit maruhanë me peshë 1.01 gram, e cila i sekuestrohet nga ana e zyrtarëve policor,-

**Me këtë ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve ,substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së.**

Andaj, Gjykata, në kuptim të nenit 275 par.2 të KPRK-së, dhe neneve 4,7, 8 par.1, 9,10 par.1,17 par.1, 21 par.1 dhe 2, 41, 42 par.1 nënpar.1.1, 43 par.1 nënpar.1.2 dhe 1.3, 45, 46, 47, 73, 74, të KPRK-së, si dhe nenit 365, 366 , 450 dhe 463 të KPPRK-së, të pandehurin e :

## GJYKON

**Denohet me DENIM ME ME GJOBË në shumën prej 100 eurove (me shkronja:Njëqind euro), të cilin gjobë i pandehuri do ta paguaj pasi i që aktgjykimi të merr formën e prerë.**

Nëse i denuari nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguaj gjobën e shqiptuar me këtë aktgjykim, konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, i akuzuari do ta vuaj denimin, me burg ashtu që për çdo 20 euro të denimit të shqiptuar do të vuaj 1 (një) ditë burgu pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

***Konfrom nenit 275 par.3 të KPPRK-së konfiskohet në mënyrë të përherëshme substanca narkotike të llojit maruhanë me peshë 1.01 gram.***

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor të paguan shumën prej 30 € në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të

Krimin të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

### Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzë PP/II nr.2170-2/2016 të dt.13.11.2017, e ka ngarkuar të pandehurit, [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Kaçanikut, për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së.

Gjykata, duke vepruar sipas aktakuzës së PTH-së, me datën 29.05.2018, mbajti shqiptimin fillestar ku prezentuan prokurori i shtetit Valdet Avdiu dhe i pandehuri.

Konform nenit 246 të KPPRK-së të pandehurit pasi që i janë dhënë udhëzimet nga ana e gjyqtarit gjatë shqyrtimit fillestar përkitazi me pranimin e fajsisë, i akuzuari e ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës për veprën penale që e ngarkon prokurori i shtetit.

Në vlerësimin e pranimin të fajsisë së të pandehurit gjyqtari gjykues konform nenit 248 par.2 të KPPRK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të pandehurit, përkitazi me pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit, ashtu që prokurori i shtetit, por edhe mbrojtësi i të pandehurit janë pajtuar me pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit të cilët kanë deklaruar se mundë të shkohet me shqiptimin e dënimit.

Gjyqtari gjykues ka vlerësuar se kërkesat nga neni 248 paragrafi 1 i KPPRK-së janë përmbushur, pasi që:

- I pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajsisë,
- Pranimi është bërë vullnetarisht.
- Pranimi mbështetet në prova dhe fakte të çështjes penale që përmban aktakuza dhe materialet e prezentuara nga ana e prokurorit të shtetit me aktakuzë dhe atë: Raporti i Ekspertimit të Agjencisë së Forenzikës 2017-3463/2016 dt.20.01.9.2017, Vërtetimi për konfiskimin e sendeve i dt. 10.09.2016, fotografitë e dëshmisë si dhe provat materiale.
- akuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike, ndajshu i akuzuari është udhëzuar nga ana e gjyqtarit gjykues edhe konform nenit 383 par.2 të

KPPRK-së, përkritazi me të drejtën e ankesës vetëm për sanksionin penal, por jo edhe për shkak të gjendjes faktike, si dhe

- Konform nenit 257 të KPPRK-së, aktakuza nuk ka prova të pranueshme.

I akuzuari [REDACTED] në shqyrtimin fillestar në fjalën e tij në kuptim të mbrojtjes ka deklaruar, pasi e ka pranuar fajësinë lidhur me veprën penale që e ngarkon prokuroria është penduar thellë për atë që e ka kryer, por thekson se nuk ka mundur ti kontrolloj veprimet e veta në atë moment i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris vepër penale, kërkon falje për këtë veprim të vetin sepse tani ka filluar punën si punëtor ujësjells dhe i ka propozuar gjykatës që me rastin e matjes së dënimit si rrethana lehtësuese ti ketë theksësimet e sipër theksuara.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit kanë egzistuar të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të cilat e përbëjnë figuren e veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së.

*(Nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe Kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit duke mos administruar fare prov, pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, si dhe pa paraqitur fare fjalë përfundimtare, lidhur me këtë shih Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethana lehtësuese mori se i pandehuri ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar gjyqësor, nuk ka të dhëna se me herët të ketë qenë e dënuar me aktgjykim të formës së prerë për vepra penale, përndryshe për veprën e kryer, ka kërkuar falje për veprimet e ndërmarrura, i moshës së re i pa martuar duke qenë e bindur se me rastin konkret qëllimi i dënimit mund të arrihet, dhe një dënimi i tillë është në proporcion me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe rrethanave të kryerjes.

Mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, dhe rrezikshmerinë konkrete të veprës penale në kuptim të gjitha këtyre rrethanave duke i caktuar denim më të butë dhe ate denim me gjobë në lartësi prej 100 eurove.

Nëse i denuari nuk e paguan gjobën e shqiptuar me këtë aktgjykim, konform nenit 46 par.2 të KPRK-së, i akuzuari do ta vuaj denimin, me burg ashtu që për çdo 20 euro të denimit të shqiptuar do të vuaj 1 (një) ditë burgu pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 275 par.3 të KPRK-së konfiskohet në mënyrë të përhershme substanca narkotike të llojit maruhanë me peshë 1.01 gram.

Mbështetur në nenin 450 dhe 451 të KPPK-së obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në lartësi prej 30 €, i cili është caktuar duke pasur parasyshë gjendjen ekonomike të të akzuarit, dhe çështjen penale të zhvilluar.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Nga sa u theksua ma lart gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.


**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,**

**P.nr.2876/2017 të dt.29.05.2018**

**Zyrtari ligjor,  
Gazmend Bytyqi**

**Gjyqtari,**

**Elmaz Zenuni**



**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi Gjykatës së Apelit në Prishtinë, ankesa dorëzohet nëpërmes kësaj gjykate.